

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 582 Prot.

Tiranë, më 03.06 2016

**VENDIM Nr. 44, datë 20.05.2016**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Shpresa Gjongecaj (IA), Prof. Sandro De Maria (Universiteti i Bolonjës),

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Foinike"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Shpresa Gjongecaj (IA), Prof. Sandro De Maria (Universiteti i Bolonjës) në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Në zonën e Agorasë helenistike parashikohet të përfundojnë kërkimet rreth pronaosit të tempullit prostil, do të vijojnë gërmimet në pjesën ballore të bazilikës bizantine dhe do të vijojnë kërkimet në kompleksin monumental të periudhës romake, në terracën në jug të agorasë.
  - Në sektorin lindor do të vijojnë kërkimet e nisura në vitin 2015. Në zonën e banesave puna do të përqëndrohet në ambientet e banesës, në terracën në lindje të Banesës me 2 peristilë.
  - Vazhdimi i përpunimit të dokumentacionit të filluar në vitin 2015 në tempullin e Asklepit, Butrint.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë shtator 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**